Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës /Skupština Opštine/Municipality of Assembly

EKSTRAKT NGA PROCESVERBALI I MBËLEDHJES SË KALUAR TË KUVENDIT KOMUNAL I MBAJTUR MË DATËN: 27.02.2019.

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 3.4 si dhe 5 të Statutit të Komunës së Skenderajt, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

F T O H E N I

Qe te merrni pjesë ne mbledhjen e Kuvendit komunal e cila do te mbahet me datën 27.02.2019, me fillim në ora 10:00 në sallën e Kuvendit Komunal.

R E N D D I T E

Për ketë mbledhje propozoi ketë:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
4. Propozim – Vendim nr. 11-400/01-0008223/19, i datës 11.02.2019, për fillimin e hartimit të Statutit të ri të Komunës së Skenderajt,(raporton Kryetari i Komisionit për Statut dhe Rregullore, z. Ramiz Shala);
5. Raporti i punës së Ekzekutivit për vitin 2018, Komuna Skenderaj, nr. 02-052/01-0008154/19, i datës 08.02.2019, (raporton Kryetari i Komunës, z. Bekim Jashari);
6. Propozim – Vendim nr. 02-400/01-0010640/19, i datës 20.02.2019, për ngritjen e planit te të hyrave vetanake për vitin 2018 dhe destinimin e tyre, si dhe bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 për destinim për vitin 2019,(raporton drejtori z. Mehmet Berisha);
7. Informatë nga DSHP-ja nr. 09-217/01-0007721/19, e datës 07.02.2019, lidhur më mbrojtjen nga zjarri në Komunën e Skenderajt, (raporton drejtori z. Ibush Hetemi);
8. Pyetjet e Këshilltarëve nën pikën të ndryshme.
9. Propozim – Plani i punës së komitetit për mbrojtje dhe shpëtim, (pikë shtesë, raporton kryesuesi i komitetit z. Berat Dajaku).

Kryesuesja – Po fillojmë me seancën e Kuvendit, përshëndetje për Kryetarin, Nënkryetarin, Drejtoret te drejtorive, anëtaret e Kuvendit përfaqësuesit e MAPL-së, KFOR-it, shoqërisë civile, media dhe ju gjithë te pranishëm, në sallë janë te pranishëm 24 anëtare te Kuvendit, mungon Berat Dajaku i cili do na u bashkëngjitet gjatë seancës, Latif Smakiqi për shkaqe shëndetësore,

Drenusha Hajzeri – Geci, pastaj, Donika Rushiti për shkaqe shëndetësore, dua të ju njoftojë se të gjitha pikat e rëndit të ditës janë diskutuar në kpf, përveq pikës shtesë, për të cilën do na e prezantoj anëtari i komitetit për mbrojtje dhe shpëtim Naser Bajraktari.
Naser Bajraktari – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po e prezantoj në pika të shkurta propozim – planin e punës së komitetit për mbrojtje dhe shpëtim për vitin 2019, pasi që ende nuk na është bashkangjitur kryesuesi i komitetit Berat Dajaku, Komitetit për mbrojtje dhe shpëtim në mbështetje të nenit 51 paragrafi 2 të ligjit për vetëqeverisje lokale, nenit 45 paragrafi 2 të statutit të Komunës së Skenderajt, si dhe në mbështetje të udhëzimit administrativ për komitete të përhershme në Komuna, komiteti i formuar me vendim të kuvendit të Komunës së Skenderaj ka hartuar këtë plan të punës për vitin 2019, që e shihni në material, të gjitha mbledhjet nëpër muaj pikat e rëndit të ditës që do të diskutohen, ndoshta nuk është e nevojshme të lexoj të gjitha, nëse keni ndonjë pyetje urdhëroni.
Kryesuesja – E hapi diskutimin, pasi që nuk ka të lajmëruar për diskutim, shkojmë ne votim, konstatojmë se me 24 vota për, asnjë kundër, dhe asnjë abstenim, propozim – plani i punës i komitetit për mbrojtje dhe shpëtim hynë në këtë rënd dite, vazhdojmë me pikën e radhës.
Miratimi i rëndit të ditës – E hap diskutimin, pasi që nuk ka të lajmëruar për diskutim, shkojmë ne votim, konstatojmë se me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet rëndi i ditës për këtë seancë, vazhdojmë me pikën e radhës.
Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar – Nëse keni ndonjë vërejtje urdhëroni, konstatojmë se me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim pa asnjë vërejtje miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar, vazhdojmë me pikën e radhës.
Propozim – Vendim nr. 11-400/01-0008223/19, i datës 11.02.2019, për fillimin e hartimit të Statutit të ri të Komunës së Skenderajt,(raporton Kryetari i Komisionit për Statut dhe Rregullore, z. Ramiz Shala);
Ramiz Shala – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për Kryetarin, Nënkryetarin, koleg drejtor, dhe ju të gjithë të pranishmit, siq e dini se me vendim të Kuvendit është themeluar komisioni për statut dhe rregullore e që kryetar i këtij komisioni jam unë, andaj në emër të këtij komisioni po e prezantoj këtë propozim vendim për fillimin e hartimit të statut të ri të Komunës së Skenderajt, pasi qe e dini edhe ju se është kërkesë imediate ta kemi një Statut të ri për Komunën e Skenderajt, pasi që kemi Statut të vjetër e që legjislacioni ka ndryshuar në Kosovës e tash është problematike zbatimi i statut, andaj kërkojmë nga ju që ta miratoni këtë propozim e që komisioni të fillon hartimin e Statut të Komunës së Skenderajt.
Kryesuesja – E hap diskutimin.
Fitore Mangjolli – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, hartimi i një statuti të ri për Komunës e Skenderajt është i nevojshëm, mirëpo është shqetësuese se nje dokument kaq i rëndësishme të këtë gabime të shumta drejtshkrimore, gjuhësore, ju kisha propozuar që ta angazhoni një lektor në Komunë e këto gabime në materiale.
Pajazit Isufi – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, hartimi i një statuti të ri është me e se nevojshme, pasi që statuti aktual i ka mbi 11 vite që është hartuar, mirëpo pajtohem me atë çka tha kolegia Fitore, pasi që po shihen se materialet po na vijnë me gabime të shumta drejtshkrimore, pastaj shihet gabime ne hapa ne procedura në këtë propozim, pasi që inicimin për statut e benë Kryetari, apo 1/3 e anëtarëve të Kuvendit ose 10% e votuese, ky propozim është dashur të na vije nga Kryetari e jo nga drejtoria e kulturës, për këtë do na e kthen MAPL-ja për rishqyrtim.
Ismet Salihu – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për Kryetarin, kabinetin qeveritar, dhe ju të gjithë të pranishmit, hartimi i një statuti të ri është me se i nevojshëm e përkrahi këtë

propozim, e përkrahi mendimin e kolegut parafolësit, ky propozim është dashur të na vije nga Kryetari, mirëpo Kryetari ka dashur ta respektoj Kuvendin, sepse ka mundur vetëm ta sjell për diskutim publik dhe për miratim në finale.
Hysni Mehani – Faleminderit Kryesuese, ishin me vend që u dhanë vërejtjet se Kryetari është dashur ta sjell këtë propozim e jo drejtoria e kulturës, pastaj shqetësuese është se vërejtjet që po i japin në kpf nuk po respektohen as nuk po merren parasyshë, unë jam pro hartimit të statutit, por të jetë qasje ma konstruktive të konsultohen të gjithë për këtë, faleminderit.
Ramiz Shala – Faleminderit përshëndetje edhe njëherë, dy parafolësit patën të drejt, mirëpo Kryetari i delegon kompetencat tek komisioni, Kryetari i bënë kërkesë komisionit, e më pastaj komisioni fillon hartimin e statutit, pastaj për gabime gjuhësore e vëretet është se ka gabime sepse unë jam jurist nuk jamë gjuhëtar lëshohen gabime gjuhesore, ndërsa për angazhim te lektorit e dimë se është problem rritja e numrit të stafit të Komunës.
Kryesuesja – Atëherë shkojmë ne votim të propozim – vendimit për fillimin e hartimit të statutit të ri të Komunës së Skenderajt, konstatojmë se me 23 vota për, asnjë kundër dhe 2 abstenime, miratohet propozimi në fjalë, vazhdojmë me pikën e radhës.
Raporti i punës së Ekzekutivit për vitin 2018, Komuna Skenderaj, nr. 02-052/01-0008154/19, i datës 08.02.2019, (raporton Kryetari i Komunës, z. Bekim Jashari);
Kryetari i Komunës, z. Bekim Jashari – Faleminderit Kryesuese përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Gjatë periudhës një vjeçare është qeverisur mbi bazën e parimeve të të cilat janë Transparenca dhe Llogaridhënia.

Në këtë periudhë raportuese ka mbajtur 373 takime zyrtare brenda dhe jashtë zyrës së tij, me personalitete të ndryshme, duke përfshirë edhe aktivitete tjera dhe për të gjitha këto takime janë lëshuar edhe komunikata zyrtare.

Zyra e Kryetarit, gjatë periudhës raportuese Janar- Dhjetor ka mbajtur dy (2) takime me publikun, ashtu siç e parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale, ku janë diskutuar të gjitha aktivitetet e Komunës. Poashtu janë mbajtur edhe katërmbëdhjetë (14) dëgjime buxhetore nëpër bashkësi lokale dhe në qytet, ndër këto dëgjime buxhetore ka pasur të organizuara dëgjime buxhetore vetëm me rini dhe dëgjime buxhetore me gratë. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë mbajtur takimet e rregullta me qytetarë javore çdo të enjte nga ora 09:30 dhe pastaj mujore ku gjithsej janë mbajtur njëzetetetë (28) takime të tilla, ku kanë marr pjesë rreth 900 qytetarë.

Në vitin 2018 Zyra e Kryetarit ka vendos standard të ri sa i përket transparencës publike, duke publikuar për herë të parë në histori kontratat e prokurimit të nënshkruara nga Komuna e Skenderajt me të gjithë operatorët ekonomik

Në perudhën Janar- Dhjetor, janë hartuar dhe miratuar edhe rregullore të reja për komunën e Skenderajt të cilat nuk kanë qenë më parë. *Rregullorja për Kriteret e Vendosjes së Objekteve të përkohshme në hapësira Publike*, si dhe është bërë Plotësim-Ndryshimi i Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba. Për të cilat janë mbajtur katër (4) dëgjime publike për të marr opinionet e qytetarëve dhe të gjithë kontribuuesve të profesioneve të ndryshme në hartimin sa më të mirë të këtyre rregulloreve.

Në këtë periudhë raportuese për vitin 2018, janë regjistruar përmes intranetit të brendshëm 1442 kërkesa nga qytetarët, të cilave i është kthyer përgjigjëje dhe janë nxjerrur 390 vendime. Poashtu janë mbajtur të gjitha mbledhjet e rregullta me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Ø **Në vazhdim po paraqesim disa nga veprimet e ndërmarra gjatë vitit 2018:**

- Parku i Biznesit me sipërfaqe prej 36 hektarë;
- Kemi përfunduar procesin e rivarrimit të dëshmorëve në Kompleksin Memorial në Marinë;
- Arritëm të sjellim dhjetëra investitorë të interesuar për investime në sektorë të ndryshëm, ndër ta edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
- Dyfishuam shumën nga 10 mijë në 20 mijë euro për transportin e nxënësve të shkollave të mesme;
- Kemi planifikuar buxhetin edhe për ndarjen e 100 bursave për student;
- Kemi ndërtuar fushën ndihmëse të futbollit, me bari sintetik, e para e këtij lloji në Ballkan.
- Janë ndërtuar 11 shtëpi për të pastrehët, në bashkëpunim me donatorë dhe shoqata të ndryshme;
- Kemi nenshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën "Jetimat e Ballkanit" për ndertimin e 25 shtëpive, ndërsa për çdo shtëpi komuna do të financon 5,000 Euro kurse shoqata 13,500 Euro, po ashtu Shoqata Jetimat e Ballkanit do t'i ndertoj edhe 5 shtëpi të tjera për familjet që nuk kanë të zgjihur çështjen e strehimit;
- Kemi fituar pajisje për nevojat e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj në vlerë prej 140 mijë eurove;

· Kemi filluar për herë të parë projektin e ofrimit të trajtimeve shëndetësore për të sëmurët nëpër terren, që nënkupton ekipet mobile të Caritas, vizitojnë nëpër shtëpi qytetarët e sëmurë;

· Kemi bërë hapjen e puseve (bunarëve) për nevojtarët, në bashkpunim me shoqatën ‘’Qatar Charity’’.

· Kemi fituar donacion nga Qeveria e Zvicrës në vlerë prej 20 mijë eurove pajisje mjekësore dhe të tjera, si rrjedhojë e takimeve jashtë vendit.

· Kemi mbështetur 216 fermerë me subvencione, grante, pajisje bujqësore, vegla bujqësore dhe të tjera.

· Përfunduam sistemin e ujësjellësit në Kryeshefc, për ato lagjet që kanë qenë në projekt.

Ø **Realizimi i Projekteve Infrastrukturore gjatë Vitit 2018**

· Asfaltimi i rrugëve në fshatin Klinë-Prekaz me segmente (34 segmente)

· Asfaltimi i rrugës unazore në qytet Klinë –Llaushë

· Asfaltimi i rrugës Prekaz Gofile (6 segmente)

· Asfaltimi i rrugës Likovc

· Asfaltimi i rrugës në Runikë

· Asfaltimi i rrugës Vitak-Kllodernicë

· Asfaltimi i rrugëve në qytet

· Ndertimi i Kanalizimit në Runik

· Ndertimi i Kanalizimit në Polac

· Kanalizimi në qytet

REALIZIMI I PROJEKTEVE GJATË VITIT 2018 DHE TE BARTURA NE VITIN 2019

· Asfaltimi i rrugës Morinë-Kryshevc (17 segmente) ------(90%-punë të realizuara)

- Kanalizimi në fshatin Prekaz-Mikushnicë-Lubavec------(50%-punë të realizuara)
- Kanalizimi në fshatin Llaushë------(50%-punë të realizuara)
- Kanalizimi në fshatin Klinë e Ulët, Mesme, Epërme-Kuqicë------(20%-punë të realizuara)
- Kanalizimi në BL Qirez--------(12%-punë të realizuara)
- Kanalizimi në fshatrat Vitak –Kllodernicë------(20%-punë të realizuara)
- Ndertimi i shkollës në Qirez------(95%-punë të realizuara)
- Ndertimi i shkollës në Qubrel ------(50%-punë të realizuara)
- Ndertimi i shkollës Hamëz Jashari ------(85%-punë të realizuara)
- Ndertimi i shkollës Makermal ------(63%-punë të realizuara)
- Ndertimi i shkollës në Polac------
- Palestra Sportive- vazhdim------(56%-punë të realizuara)
- Ujësjellësi në Kuqicë------(92%-punë të realizuara)
- Mirëmbajtja dhe riparimi i rrugëve------(27%-punë të realizuara)
- Hartimi i projekteve teknike
- Ndërtimi i kolektoreve kryesor të ujrave të zeza në mes komunës së Drenasit dhe Skenderajt
- Renovimi i Shtepisë së Kulturës------(70%-punë të realizuara)
- Asfaltimi i rrugëve në Izbicë------(85%-punë të realizuara)
- Kanalizimi në fshatin Rezallë------(90%-punë të realizuara)
- Rregullimi i infrastrukturës së zonës sportive në Prekaz------(45%-punë të realizuara)
- Rregullimi me kocka betoni i rrugëve me kubëza në lagjën III------(62%-punë të realizuara)

Kryesuesja – E hapi diskutimin,
Hysni Mehani – Faleminderit kryesuese, shihet një raport ku ma shumë flitet për shoqata humanitare se sa për punë konkrete që ka bërë komuna në këtë periudhe, pastaj shihet të drejtoria e urbanizmit krijon amulli duke mos i specifiku projektet, të drejtoria e bujqësisë tek bashkësia lokale e Qirezit ku janë 6 fshatra e është e çuditshme 2 përfitues të mjeteve bujqësore janë djem të agjës së drejtoritë bujqësisë të fshatit Krasaliq, pastaj tek sektori i bletarisë 3 përfitues të të njëjtit mbiemër Qemajli, le të na sqaroj drejtori për këtë.

Kryetari i Komunës, z. Bekim Jashari – Përshëndetje edhe njëherë, vërtetë dikush mundohet qe edhe boren ta bërë të zezë, mirëpo nuk mundët sepse është proces natyror e nuk mund ta ndryshoj, ka qenë zotimi i imi që të gjitha punët që do punohet të jenë transparente e t evidentohen, jemi munduar që te jemi më të shkurt në këtë raport me atë se çfarë është punuar, mirëpo për të gjitha janë edhe drejtorët e drejtorive këtu mund të ju japin sqarime.
Hysni Mehani – Kryetar ne jemi këtu për ti shqyrtuar e diskutuar këto propozime, nuk të kam sulmuar asnjëherë si Bekim po si Kryetar Komune.
Fitore Mangjolli – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje edhe njëherë, prapë po dal me kërkesa, dua të bëjë një pyetje lidhur me kanalizimin Prekaz, Lubovec, Mikushnic, ne cilën fazë është ky projekt.
Isa Fjezullahu – Përshëndetje edhe njëherë desha të pyesë Kryetarin rreth parkut të biznesit e ka dërguar Presidenti në Kushtetuese, a është në atë pako me te Komunave tjera, si është gjendja, pastaj desha të pyesë për rrugën tashme të famshme, Terrnavc – Kuqic a është bartur prapë për këtë vite.
Besarta Meha – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje edhe njëherë, tek ky raport me shqetësoj çështja e numrit shumë të vogël të përfituesve të garantëve nga drejtoria e bujqësisë, desha të pyesë drejtorin pse ky nr kaq i vogël i grave përfituese të këtyre garantëve, si dhe për puseta desha te pyesë se si ka rrjedh ky proces.
Pajazit Isufi - Faleminderit Kryesuese, pune e mirë gjatë vitit raportues rivarrosja e dëshmorëve në varrezat e Morinës, pastaj desha të pyesë për kontestet e humbura a ka ndërmarrë diçka Komuna.
Sokol Sallahu – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha ti përgjigjem Hysit ne pyetjet për përfituesit e projekteve nga drejtoria e bujqësisë, ti ma se pari a e dinë se sa vet kanë aplikuar prej atyre 6 fshatrave a ki informata, apo vetëm po flet, ju kamë thëne për çdo informacion ejani ne drejtori të bujqësisë ju informojmë, pastaj po përgjigjem për nr e grave përfituese të garantëve nga drejtoria e bujqësisë janë 24 gra përfituese, nuk ka këtu kurrfarë diskriminimi kush i plotëson kritetet përfiton.
Sanije Ahmeti – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, sa i përket kanalizimit të fshatit Prekaz, lubovec, Kuqic është projekt tre vjeçar, pastaj rruga Kuçic – Terrnavc ka kaluar në këtë buxhet e do të fillojnë punimet këtë vite.
Kryetari i Komunës, z. Bekim Jashari – Sa i përket parkut të biznesit është ne pako edhe me te Komunave tjera, Presidenti e ka dërguar në Kushtetuese besoj se shumë shpejt do të rregullohet kjo çështje, ndërsa rruga Kuqic- Terrnavc këtë vite do të fillojnë punimet.
Ismet Salihu – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje edhe njëherë, shihet një raport shumë voluminoz, e që do duhet të vijë ma shumë në mënyrë tabelare, prapë mbetet shqetësuese vonesa e përfundimit të projekteve si palestra sportive, Gjimnazi, Shkolla ne Qubrel.
Kryetari i Komunës, z. Bekim Jashari – Gjimnazi dhe palestra sportive po besoj se shumë do të përfundojnë, kështu na është premtuar.
Osman Veliu – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, rreth hapjeve të bunarëve, na është premtuar që do fillon prapë do na ndihmon shoqata ne hapjen edhe te 100 bunrareve e qe ne do i përzgjedhim prapë ato familje nevojtare.
Agron Kajtazi – Faleminderit Kryesuese, desha ta ngriti çështjen e Ambulantes në Klladernicë, që i mungon uji rryma.
Osman Veliu – Për bunarin ne Ambullanten e Klladernicës, shoqata e ka shiqu mundësit për hapjen e një bunari mirëpo nuk ishin kushtet atu, e do të shikohet mundësia prapë për të bërë zgjidhje atu.

Berat Dajaku – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, te drejtoria e administratës certifikata të vdekjes 2,525 desha të pyesë se a bashkëpunon drejtoria ose Komuna me bashkësi Islame ne Skenderaj, pastaj për mbulimin e shpenzimeve të varrimit më është thënë se është paraparë për vitin 2019, pastaj shihet raport me 4 rreshta i autoparkut e ku është dashur të jenë shpenzimet e automjeteve gjendja e tyre e jo aq pakë për atu, pastaj të prokurimi ma shumë ka për detyrat dhe përgjegjësit e ati shërbimi se sa për punën që është bërë, pastaj në raport të drejtorisë së financave ceket se ka pasur rishikim të buxhetit e në realitet nuk kemi pasur rishikim fare, për çka ka të bëjë kjo.
Ibush Hetemi – Faleminderit Kryesuese, sa i përket bashkëpunimit të Komunës me bashkësinë Islame kemi bashkëpunim, qytetarët i kanë afatet ligjore kur me i fshi të vdekuri, pastaj për mbulimin e shpenzimeve për varrim të qytetarëve tonë e kemi paraparë një shumë prej 38 mijë Euro për këtë vite.
Mehmet Berisha – Faleminderit Kryesuese, sa i përket pyetjes për rishikim të buxhetit, nuk kemi pasur, mirëpo i kemi pas tri here radhas ngritjen e planit të të hyrave vetanake, pastaj për shpenzimet e autoparkut do ju vijnë në raport të shpenzimeve të buxhetit.
Kryesuesja - Atëherë shkojmë ne votim, konstatojmë se me 15 vota për, 1 kundër, 3 abstenim, përkrahet raporti vjetor i punës së ekzekutivit për vitin 2018, vazhdojmë me pikën e radhës.
Propozim – Vendim nr. 02-400/01-0010640/19, i datës 20.02.2019, për ngritjen e planit te të hyrave vetanake për vitin 2018 dhe destinimin e tyre, si dhe bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 për destinim për vitin 2019,(raporton drejtori z. Mehmet Berisha);
Mehmet Berisha - Faleminderit Kryesuese, i dhashë sqarimet edhe me herët për këtë propozim – vendim, tabela e parë është shuma 484,688,69€ të hyra që janë inkasuar gjatë muajt Nëntor dhe Dhjetor, pastaj tabelën e dytë i shihni mjetet që do të destinohen nëpër projekte të ndryshme, si ne DKA për bursa, pastaj zërimi i sallës së Kuvendit, të dy këto shuma e japin shumë prej 815,000.00€, kjo ishte në pika të shkurta nëse keni pyetje urdhëroni.
Kryesuesja – E hapi diskutimin për këtë pikë të rëndit të ditës.
Albert Rexhpi – Faleminderit Kryesuese, i kemi dhëne vërejtjet edhe me herët për rritjen e shpenzimeve për riparim të automjeteve, pastaj desha të pyesë për shumën që është nda prej 20,000.00€ a është planifikuar të blihet një veture apo dy.
Mehmet Berisha – Planifikohet të blihet një veturë për nevoja të komunës.
Berat Dajaku – Përshëndetje, këtu në tabelën e parë, ku thuhet kthimi i obligimit për Leonora Jakupi shuma 28,000.00€ a është fjala për shumë si garanci banare, masi që unë kamë qenë pjesë e ati Komisioni e jam në dijeni për këtë çështje, pastaj desha të pyesë pse shuma e njëjtë 20,000.00€ blera e veturës zyrtare e kamionit.
Beqir Veliu – Desha të pyesë se a keni planifiku për laptop për anëtarë të Kuvendit, se shumica e Komunave u kanë siguruar.
Hysni Mehani – Desha të pyesë drejtor çka keni menduar të asfaltimi i rrugës Vitak – Kllladernicë, 377.00€ shuma e vogël, ndërtimi i QKMF-së çka nënkupton, pastaj blerja e veturës zyrtare a është në pyetje blera e veturës që e ka shkatërruar drejtori i kulturës.
Musaj Hajdari - A keni menduar që të hyrat vetanake me i përdor për investime kapitale e jo për paga dhe mëditje.
Mehmet Berisha – Faleminderit, çështja e Kamionit ka qenë tender i hapur nga Gizi Gjerman për blerjen e kamionit të bajtur jo të ri, ajo shumë është caktuar mund edhe mos të shpenzohet ajo shumë, ndërsa për automjet është planifikuar një veturë të blihet për nevoja të Komunës, të hyrat vetanake nuk mund të përdoren për paga dhe mëditje.

Hysni Mehani – Nëse ndërtimi i QKMF-së, është projekt i vjetër atëherë pse i mungon kodi, pse është projekt i ri dhe pse i mungon kodi.
Mehmet Berisha – Të ndërtimi i QKMF-së, është projekt i financuar nga Ministria, janë mjete që kanë mbetur pa u paguar.
Kryesuesja – Atëherë shkojmë ne votim, konstatojmë se me 19 vota për , asnjë kundër dhe 2 abstenime miratohet propozim – vendimi për ngritjen e planit te të hyrave vetanake dhe destinimin e tyre si dhe bartjen e të hyrave për vitin 2019, vazhdojmë me pikën e radhës.
Informatë nga DSHP-ja nr. 09-217/01-0007721/19, e datës 07.02.2019, lidhur më mbrojtjen nga zjarri në Komunën e Skenderajt, (raporton drejtori z. Ibush Hetemi);
Ibush Hetemi – Faleminderit Kryesuese, nëse e shihni të arsyeshme nuk po e lexoj këtë informatë mbasi ja u kemi përcjellur me kohë, nëse keni ndonjë pyetje urdhëroni.
Kryesuesja – E hapi diskutimin, pasi që nuk kemi për diskutim, shkojmë ne votim, konstatojmë se me 21 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim përkrahet informata nga DSHP-ja, vazhdojmë me pikën e radhës.
Propozim – Plani i punës së komitetit për mbrojtje dhe shpëtim, (pikë shtesë, raporton kryesuesi i komitetit z. Berat Dajaku),
Berat Dajaku – Faleminderit Kryesuese, nëse e shihni të arsyeshme nuk po e lexoj mbasi e keni para jush materialin.
Kryesuesja – E hapi diskutimin.
Pajazit Isufi – Desha të pyesë se a keni ndërmarr diçka rreth nr emergjent.
Ibush Hetemi – Për nr emergjent ju kemi thënë se na jepni kohë të krijojmë mundësi, sepse kërkon zyre e staf për të funksionu.
Agron Kajtazi – Desha të pyesë Berat se a ka mundësi me caktu zjarrfikës vullnetar për raste emergjente.
Isa Fejzullahu - Desha të pyesë se a ka alarm akustik ne Komunën tonë, dhe a është i nevojshëm të jetë.
Kryesuesja – Pasi që nuk kemi tjerë për diskutim, shkojmë ne votim, konstatojmë se me 20 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratohet propozim – plani i punës së komitetit për mbrojtje dhe shpëtim për vitin 2019, vazhdojmë me pikën e radhës.
Pyetjet e Këshilltarëve nën pikën të ndryshme.
Hysni Mehani – Faleminderit, pyetjet e mia për këtë seancë janë **Për Drejtorinë Administratës**
Kush është përgjegjës i Zyrës së Prokurimit, a vjen ai në punë, a merr rrogë nga komuna, si dhe, a do duhej të lejoni që një post kaq të rëndësishëm ta mbajë një militant partiak?
Drejtorisë së Arsimit
Së fundmi në fshatin Krasaliq, një kurir ka shkuar në pension. Për pozicionin e tij ishte mbajtur një konkurs. Në vendimin Nr. 520/2018 të datës 25. 09. 2018 është përzgjedhur kandidati Rr. D., sipas kandidatëve tjerë, kandidati i përzgjedhur nuk kishte hyrë në teste fare, ishte përzgjedhur sepse ua kishte dhanë 2500€ të mëdhenjve - thonë ata. Njëri nga kandidatët ankoi në gjykatë, dhe, gjykata e ka konstatuar shkeljen duke e përzgjedhur një kandidat tjetër për ate,pozicion. Pyetja është: nëse komisoni juaj e zgjodhi njeriun e duher pse gjykata e anuloi vendimin, dhe a keni ndërmarrë masa ndaj atij komisioni?
Ibush Hetemi – Po përgjigjem në pyetje, a është në punë Haxhi Bejta po është në punë, a merr rrogë Haxhi Bejta po merr, a është shef Haxhi Bejta jo nuk është është transferuar në një sektor tjetër.
Bekim Latifi – Faleminderit rreth pyetjes për konkursin, të gjithë kandidatet janë ftuar në teste, janë zhvillu të gjitha procedurat ligjore, kontestuese ka qenë kualifikimi, qe komisioni nuk ka

mundur ta vërtetoj atë diplom me pastaj inspektorati e ka vërtetu ka nxjerr vendim ne e kemi zbatu vendimin e inspektoratit, nuk ka pas vendim të Gjykatës ashtu siç e kemi konstatu ju.
Hysni Mehani – Kanë qenë në garë dy kandidat, njeri ka qenë me kualifikim e është përzgjedhur ai pa kualifikim.
Bekim Latifi – Nuk qëndron ajo çfarë e thatë, ta them këtë me bindje të plot.
Besarta Meha – Faleminderit Kryesuese, pyetjen e parë po e shtyjë për seancë të radhës, mbasi që nuk është drejtori, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka marrë një vendim për vendosjen e flamujve që tregojnë origjinën e produktit, Ministria është duke bashkëpunuar me inspektoret e Komunave për zbatimin e këtij vendimi, pyetja ime është si po shkon ky proces a është ndëshkuar ndonjë biznes për mosrespektim, të këtij vendimi kur merret parasysh që dyqanet nëpër fshatra nuk shihet që kanë vendosur flamujt për origjinë të mallit, faleminderit.
Ibush Hetemi – Inspektoret e Komunës po bëjnë punë të mirë, për respektimin e vendimit për vendosjen e flamujve për origjinën e produkteve , ma shumë janë të fokusuar në markete të mëdha.
Kryesuesja – Pasi që i shqyrtuam të gjitha pikat e rëndit të ditës, e mbylli këtë seancë, kaloni mirë deri në takimin e radhës.

Procesmbajtësi;
Jeton Osmani
_____

Kryesuesja e KK-së;
znj, Fatbardha Haliti
_____